



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **23.08.2021** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi nën kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, ne mungesë të kryesuesit të Komitetit për shkak të gjendjes me Covid atëherë mbledhjen do ta udhëheqë unë Dusan Stojanovic, përshëndes anëtarët e Komitetit për komunitete, për përfaqësuesit e OSBE-së, mediave dhe gjithë të pranishmit. Ky është takimi i tretë për vitin 2021, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

- 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë rreth vizitave të realizuara në shkollat e komunës së Rahovecit;**
- 3. Informatë rreth KAB-it për vitin 2022-2024;**
- 4. Të ndryshme.**

Dusan Stojanović –Të nderuar para se me qitë rendin e ditës në votim a keni diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth Procesverbalit të kaluar, atëherë nëse jo e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informatë rreth vizitave të realizuara në shkollat e Komunës së Rahovecit.

Dusan Stojanović – Duke marrë parasysh që pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me vizitat e realizuara në shkollat në gjuhën shqipe nga Kryesuesi i Komitetit **z. Bajram Morina** dhe sigurohet e ka marrë mbi vete me i realizue ato vizita atëherë ai e ka informatën të cilën e ka përgatit, kështu që këtë pikë e lejmë për mbledhjen e ardhshme që me informatën që e ka përgatit mund të ju informoj gjerësisht për të gjitha rreth kësaj pike.

3. Informatë rreth KAB-it për vitin 2022-2024.

Dusan Stojanović – Sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore është e publikuar në webfaqen e internetit edhe janë të gjitha shënimet e nevojshme që duhet me i pas, pasi ne mungesë të drejtorit të financave **z. Afrim Limani**, ne ju udhëzojmë që me marrë edhe me i pae të gjitha sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore, pasi drejtori nuk ka pasur mundësi me ardhë në mbledhje për shkak të obligimeve të veta. Kështu që ju sugjerojmë në webfaqe të komunës mund të gjeni të gjitha informatat sa i përket KAB-it.

Lendrit Qeli – Përshëndetje për të gjithë, ndoshta për shkak të procesverbalit do të ishte mirë me qenë e faktuar, Zyra Komunale për komunitete dhe kthim duke ju referuar edhe plotësim ndryshimit në kuptimin të buxhetit që është i paraparë ka propozue që të paktën në vitin 2022 të ketë shtesë të buxhetit për zyrën komunale për komunitete dhe kthim sepse duke ju referuar informatave me buxhetin aktual që e kemi 40%

e mjeteve duhet te jetë pjesë e shpenzimeve te parapara për fshatin Hoçë e Madhe duke u bazuar ne ligjin e ri për mbështetjen e këtij vendi dhe ne kemi kërkuar që tash e tutje që përpos buxhetit aktual që e kemi për investimet kapitale, te kemi edhe një shume te konsiderueshme te subvencioneve sepse përmes kësaj linje buxhetore i kemi duart me te lira ne kuptimin e intervenimit te çështjeve që kanë te bëjnë me komunitete dhe ju kemi drejtuar kryetarit te Komunës, nënkryetarit te komunës dhe gjithashtu drejtorit te financave për mbështetje dhe po shpresoj që një gjë e tillë do te realizohet gjate vitit 2022.

Atëherë meqë nuk kemi asnjë koment rreth kësaj pike, unë ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin e juaj në këtë takim dhe shihemi në takimin e radhës.

Dusan Stojanoviç – Faleminderit për informatën z.Lendrit, atëherë kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës:

4. Të ndryshme.

A ka dikush me shtue diçka sa i përket pikës së katërt të rendit te ditës.

Informatat lidhur me kontejnerët për mbeturina për arsye se 75 prej tyre kanë qenë te dedikuara për Lagjen e Epërme mirëpo ky numër i përgjithshëm është i ndarë ne tre pjesë dhe ju është shpërndarë komunitetit ne Lagjen e Epërme në Hoçë te Madhe dhe në Zoqisht, kështu që nëse keni ndonjë informatë rreth kësaj atëherë mundësisht me na tregue se a do te vazhdoj faza e dytë e shpërndarjes se këtyre kontejnerëve dhe si qëndron problemi.

Lendrit Qeli – Kam komunikuar me drejtorin e shërbimeve publike sepse mënyra se si janë shpërndarë nuk e ka koordinimin si duhet dhe kemi të bëjmë me kontejnerë të vegjël apo shtëpiak ndërsa ne si zyre kryesisht i kemi të paguara për kontejnerë te mëdhenj që duhet me qëndruar nëpër lagje të komuniteteve dhe që janë me kapacitet të madh, kështu që po i presim që kompania me i sjellë ato pasi janë të paguara dhe kemi arrit që borxhin që e kemi pasur ndaj kompanisë në kuadër të projektit për investime kapitale me u realizue dhe po presim që sa me shpejt kompania me i sjellë kontejnerët ndërsa për kontejnerët e vegjël apo shtëpiak kjo është ne koordinim me drejtorin e shërbimeve publike dhe me kompaninë e pastrimit ne komunën e Rahovecit. Ka filluar dikush me i marr mirëpo ne këtë drejtim nuk ka pasur koordinim te mire dhe unë kam kërkuar prej drejtorit që te rregullohet kjo si çështje dhe drejtori me ka premtuar që shume shpejt ne koordinim me Ekoregjonin të realizohet sa më shpejtë kjo që është e mundur për te gjithë banorët që jetojnë në pjesën e epërme dhe nëpër zona ku jetojnë pjesëtare të komuniteteve sepse është e rregulluar për te gjithë që të kenë çasje ne këta kontejnerë.

Dusan Stojanoviç – Faleminderit shume z.Lendrit, atëherë a ka dikush me shtue diçka rreth kësaj pike.

Ramë Bersha – Përshëndetje për të gjithë, edhe pse është numër i vogël po sigurisht se kanë arsyet e tyre. Nga kryesia e fshatit Xerxe, kam dëgjuar se ka bërë kërkesë për shumë projekte dhe ne ato takime nuk kam marr pjesë mirëpo unë e shoh se është ngarkesë e madhe për te gjitha ato projekte ne atë kërkesë, por si duket kanë harruar që komuna e Rahovecit i përfshin 33 fshatra andaj me bë atë kërkesë dhe me i futë të gjitha ato projekte atëherë duhet 1/3 e buxhetit me u shpenzu për te gjitha ato projekte. Kështu që duhet që atë buxhet komunal me shpenzua ne mënyrë transparente për gjithë qytetaret e komunës se Rahovecit. Po ashtu sipas mendimit tim buxhetin duhet me shpenzua që me pas një estetik dhe para 3 muajve ne fshatin Xerxe kanë ardhur disa bimë dekoruese që duhet mbjellë për një pamje më të mirë të fshatit, por duke mos marr pjesë njerëzit që e njohin terrenin ato janë mbjellë ashtu sipas dëshirës pa ndonjë planifikim. Prandaj, kisha me thënë që buxheti dhe punët që bëhen në mënyrë të planifikuar dhe të shpërndahen në mënyrë të drejtë në gjithë territorin e komunës së Rahovecit.

Dusan Stojanoviç – Faleminderit z. Rame Berisha, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj të mbyllur mbledhjen dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi

Agim Hoti



Kryesuesi i Mbledhjes

Bajram Morina